



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 182, Datë 12.09.2024

MBI
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "NOA ENERGY TRADE" SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma "e", 5, pika 1, gërma "e", nenit 13, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin, dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1563/5 prot., datë 04.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "NOA ENERGY TRADE" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

Konstatoi se:

- Shoqëria "NOA ENERGY TRADE" sh.p.k. me shkresën nr. 1563/1 prot., datë 25.07.2024 ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 163, datë 15.08.2024 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "NOA ENERGY TRADE" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2025.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.08.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.08.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1563/4 prot., datë 16.08.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit për të vijuar me procedurën për rinovimin e licencës.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2025.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI